

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
"AL NovaSol" Sh.p.k**

Më datë 25.11.2020 , në qytetin e Tiranës është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "AL NovaSol" Sh.p.k

Themelues i shoqërisë është ortak i vetëm:

Z. Ermond Sina, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1984, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Selim Brahja, Njesia Bashkiake Nr.2, Sauk, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr letërnjoftimi: 031099103.

**NENI 1
KUADRI LIGJOR**

Shoqëria "AL NovaSol" Sh.p.k është person juridik shqiptar dhe funksion në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 2
EMERTIMI**

Emërtimi i shoqërisë është "AL NovaSol" Sh.p.k. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet Sh.p.k .

**NENI 3
SELIA E SHOQERISE**

1. Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga "Tish Dahia", Kompleksi Kika 2, Tiranë.
2. Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të ortakëve të saj .

Ermond Sina



NENI 4 KOHEZGJATJA

1. Kohëzgjatja e shoqërisë është për një afat të pacaktuar.
2. Në përputhje me parashikimet e statutit, shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj, ose mund ta zgjasë kur e sheh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 5 QELLIMI DHE OBJEKTI

1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “AL NovaSol” Sh.p.k. do të jenë aktivitete të lidhura kryesisht me: Shërbime në lidhje me studimin e potencialit të tregut apo kërkimore për pëlqyeshmëri dhe klientëve në lidhje me promocionet, konsulencë profesionale, për marketingun apo të tjera, organizimin e trajnimeve dhe eventeve të ndryshme, analiza statistikore të rezultateve..

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar është fiksuar në 100,000 lekë (njëqind mijë lekë). Ai mund të rritet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.
2. Kapitali ndahet në 1 kuotë me vlerë totale 100,000 lekë. (njëqind mijë lekë).

NENI 7 KUOTAT

Kuotat e pjesëmarrjes janë:

1 kuotë me vlerën 100 % (njëqind për qind) të kapitalit në zotërim të **Z. Ermond Sina**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1984, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: “Selim Brahja”, Njesia Bashkiake Nr.2, Sauk, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr letërnjoftimi: 031099103.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme :

Asambleja e përgjithshme krijohet nga ortakët themelues:



Z. Ermond Sina, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1984, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga: Selim Brahja, Njesia Bashkiake Nr.2, Sauk, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr letërnjoftimi: 031099103.

2. Administratori :

Administratori i shoqërisë zgjidhet për një afat 5 (pesë) vjecar, me të drejtë ripërtëritje **Z. Ermond Sina**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1984, lindur në Tiranë, banues në adresën: Rruga “Selim Brahja”, Njesia Bashkiake Nr.2, Sauk, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr letërnjoftimi: 031099103.

NENI 9

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Shoqëria do të organizohet dhe do të funksionojë në bazë të parashikimeve të përcaktuara në statut.

NENI 10

LIGJI I APLIKUESHEM

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe cdo bazë ligjore të parashikuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 11

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Palët e interesuara kanë të drejtë t’i drejtohen gjykatës kompetente për cdo kundërshtim që kanë rreth aktivitetit të shoqërisë.

NENI 12

DISPOZITA KALIMTARE

Ky akt themelimi hyn në fuqi nga data e miratimit dhe regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Akt themelimi u përpilua në dy kopje në gjuhën shqipe .

ORTAKET THEMELUES

Ermond Sina

